



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/23 Nr. i faq/Br.str/No.pg 72

Data/Datum/Date 28/04/2023

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konform Shkresës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr. 1914-2/23 të datës 27.04.23, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt.28.04.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit 01 Nr. 54/23 i datës 30.03.2023 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Kramovik

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 01 Nr. 54/23 i datës 30.03.2023 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Kramovik.
2. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- MAPL-së,
- Kryetarit të Komunës,
- Shërbimit të Kuvendit, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.72/23
Datë:28.04.2023

